

VENDIM
Nr. 150, datë 28.9.2017

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ENERGJIA VALAMARA” SHPK PËR LICENCIMIN
NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET:
“MESMAL 1”, ME FUQI TË INSTALUAR 0.410 MW; “MESMAL 2”, ME FUQI TË
INSTALUAR 1.473 MW; “MESMAL 3”, ME FUQI TË INSTALUAR 0.235 MW; “SELCA 2”,
ME FUQI TË INSTALUAR 2.388 MW DHE ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 4.506
MW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 20 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.9.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Mesmal 1”, me fuqi të instaluar 0.410 mw; “Mesmal 2”, me fuqi të instaluar 1.473 mw; “Mesmal 3”, me fuqi të instaluar 0.235 mw; “Selca 2”, me fuqi të instaluar 2.388 mw dhe me fuqi totale të instaluar 4.506 mw, për një afat 30-vjeçar, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 10.7.2017, ka filluar procedura për licencimin e shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Mesmal 1”, me fuqi të instaluar 0.410 mw; “Mesmal 2”, me fuqi të instaluar 1.473 mw; “Mesmal 3”, me fuqi të instaluar 0.235 mw; “Selca 2”, me fuqi të instaluar 2.388 mw dhe me fuqi totale të instaluar 4.506 mw, për një afat 30-vjeçar.

Pas fillimit të procedurave shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k., i është dërguar vendimi i bordit nr. 106 dhe kërkesa për plotësimin e dokumentacionit, siç është parashikuar nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” dhe kërkesa referuar korrespondencës së subjektit me ERE-n, është plotësuar si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “P” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “b” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3 dhe 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4.1.5, “Leje nga institucione të tjera”. Në lidhje me këtë kërkesë të rregullores, konstatojmë se në datën 19.9.2017, subjekti “Energjia Valamara” sh.p.k. ka depozituar dokumentacionin plotësues, me shkresën nr. 51 prot., duke deklaruar dhe dokumentuar se në datën 18.5.2017 ka aplikuar pranë Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe është në pritje të mbledhjes dhe miratimit të lejes së përdorimit të rezervës ujore.

Leja e përdorimit të ujit është një dokument i rëndësishëm së veçantë, mungesa e disponimit të të cilit e bën të pamundur ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos licencojë shoqërinë “Energjia Valamara” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Mesmal 1”, me fuqi të instaluar 0.410 mw; “Mesmal 2”, me fuqi të instaluar 1.473 mw; “Mesmal 3”, me fuqi të instaluar 0.235 mw; “Selca 2”, me fuqi të instaluar 2.388 mw dhe me fuqi totale të instaluar 4.506 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6 të nenit 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimi, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, brenda 1 muaji nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, bashkë me lejen e përdorimit të ujit, dokumentacioni i paraqitur për këtë aplikim do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti